



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E MEDIAS**

PROCESVERBAL

**I KONSULTIMT PUBLIK PËR PLANIN VENDOR TË RINISË 2026-2030 PËR
BASHKINË KAMËZ**

I mbajtur më 05.03.2026, në orën 11:30, në dëgjesë me të rinjtë dhe banorët e Bashkisë Kamëz, në kuadër të konsultimit publik për Planin Vendor të Rinisë 2026-2030, për Bashkinë Kamëz.

Takimi u zhvillua në ambientet e shkollës “Angela Merkel”.

Të pranishëm në takim:

- Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli;
- Drejtoresha e ZVA Kamëz, znj. Albana Sulçe;
- Koordinatorja Kombëtare e Projektit Rajonal të Kombeve të Bashkuara “Të Rinjtë për Barazi dhe Besim”, znj. Rodika Goci;
- Ekspertja e angazhuar e United Nation Development Program (UNDP), znj. Lorena Zajmi;
- Përgjegjësj e Qendrës Rinore Kamëz, znj. Anila Kolgjini;
- Përfaqësues të Shoqërisë Civile;
- Anëtarë të Këshillit Bashkiak;
- Anëtarë të Këshillit Vendor Rinor Kamëz;
- Gjimnazistë dhe të rinj të Bashkisë Kamëz;
- Administratorë të Lagjeve dhe Njësive Administrative të Bashkisë Kamëz;
- Staf mësimdhënës.

Takimin e hapi përgjegjësj e Qendrës Rinore, znj. Anila Kolgjini, e cila, pasi falënderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre, i njohu ata me qëllimin dhe rëndësinë e zhvillimit të kësaj dëgjese.

Më pas, fjala iu dha Drejtoreshës së ZVA Kamëz, znj. Albana Sulçe, e cila falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen dhe në veçanti Kryetarin e Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, për gatishmërinë dhe mbështetjen e vazhdueshme që ai ka treguar ndaj të rinjve.

Fjala e Kryetarit të Bashkisë Kamëz

Më pas, fjalën e mori Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, i cili shprehu kënaqësinë për praninë e tij në këtë konsultim. Në fjalën e tij ai u shpreh:

“Kamza është bashkia e tretë në vend për nga numri i të rinjve, me rreth 20 mijë nxënës. Rinia është energjia dhe e ardhmja e Bashkisë Kamëz. Jo pa qëllim, që në ditën e parë kur kemi ardhur në drejtimin e Bashkisë Kamëz, kemi vendosur në fokus arsimin. Një bashki që investon në dije, investon në të ardhmen e vendit. Sot po flasim për Planin Vendor Rinor 2026–2030, por duhet të reflektojmë edhe për atë çfarë kemi bërë deri më sot për rininë: sa e përfshirë ka qenë ajo në vendimmarrje dhe sa është dëgjuar zëri i të rinjve në Bashkinë Kamëz.”

Më tej, Kryebashkiaku Suli përmendi disa nga investimet e rëndësishme të realizuara nga Bashkia Kamëz në vitet e fundit, duke theksuar angazhimin e institucionit për përmirësimin e kushteve për të rinjtë dhe komunitetin.

Investimet e realizuara nga Bashkia Kamëz 2020–2025

Gjatë fjalës së tij, z. Suli prezantoi disa nga investimet kryesore të realizuara nga Bashkia Kamëz në vitet e fundit, ndër të cilat:

➤ Investime në arsim

- Ndërtimi dhe rikonstruksioni i 45 objekteve arsimore
 - 21 shkolla
 - 17 kopshte
 - 7 çerdhe
- Përfshirja e 19,229 nxënësve në këto institucione
- Pajisja e shkollave me laboratorë, sisteme ngrohje dhe ftohjeje, si dhe ambiente sportive
- 5,572 fëmijë të përfshirë në kopshte dhe çerdhe

➤ Mbështetje për nxënësit dhe studentët

- 1,722 bursa ekselence
 - Nga klasa 5-9, marrin 270\$ në vit dhe
 - Nga klasa 10-12, marrin 450\$ në vit
- 162 ekiye sportive , me 1550 të rinj të aktivizuar në sporte të ndryshme.
- Panairi i Librit “Kamza Lexon”.
- Klubi i Librit.

- Konkurse artistike për të rinjtë.
- Këshilli Rinor.
- Programet e ekselences dhe Praktikat e Punës.
 - 40% të stafit të administrates
 - 50% të anëtarëve të Këshillit Bashkiak
- Karta e studentit.

➤ **Hapësirat publike dhe infrastruktura për të rinjtë**

Kryetari i Bashkisë theksoi edhe zhvillimin e hapësirave publike dhe rekreative për të rinjtë, si:

- Parku i Liqenit të Paskuqanit
 - Pedonale me gjatësi 5.1 km
 - Dy parkime në të dy krahët
 - 80,000 pemë të mbjella
 - Amfiteatër
 - Moli
 - Shkallë panoramike
 - 8 fusha sportive
 - Kënde lojërash
- Shëtitorja Bathore (1 km)
- Shëtitorja Frutikulturë (1.3 km)
- Qendra Kulturore
 - Biblioteka
 - Salla e Rinisë
 - Teatri

➤ **Shërbimet sociale**

- 85 fëmijë trajtohen tek Qendëra Multifunksionale.
- 76 Shërbime lëvizëse për persona me aftësi të kufizuara (logopedi, fizioterapi, psikologji).
- Transport social falas për 500 persona nga grupet e marginalizuara.
- Trajnime për nxitjen e punësimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian.

Kryebashkiaku Suli theksoi se përveç investimeve infrastrukturore është e rëndësishme edhe përfshirja aktive e të rinjve në aktivitete komunitare dhe vullnetare, duke i ftuar ata të paraqesin ide dhe projekte pranë Bashkisë.

Ai njoftoi gjithashtu se në kuadër të Planit Vendor Rinor do të ndërtohet Qendra Rinore e Kamzës, e cila do të shërbejë si një hapësirë për aktivitete, konkurse, trajnime, kurse dhe iniciativa në fushën e teknologjisë etj. Për më tepër, për herë të parë një bashki në territorin e

Shqipërisë do të krijojë podcast-in e saj, si një platformë komunikimi dhe shprehjeje për të rinjtë.

➤ **Projektet në proces për vitin 2026**

- Qendra Rinore Kamëz
- Kopshti “Lepurushët”
- Shkolla “Dom Nikoll Kaçorri”
- Gjimnazi “Sulejman Elezi”, Laknas
- Stadiumi Valias

Fjala e Koordinatorës së Projektit

Më pas fjalën e mori Koordinatorja Kombëtare e Projektit Rajonal të Kombeve të Bashkuara “Të Rinjtë për Barazi, Përfshirje dhe Besim”, znj. Rodika Goci, e cila falënderoi Bashkinë Kamëz, të rinjtë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile për bashkëpunimin.

Ajo theksoi se projekti zbatohet në pesë vende të Ballkanit Perëndimor dhe vlerësoi përfshirjen aktive të Bashkisë Kamëz në procesin e hartimit të planit. Sipas saj, pjesëmarrja e të rinjve në këtë konsultim tregon rritjen e besimit ndaj institucioneve dhe përbën një aset të rëndësishëm për komunitetin.

Prezantimi i Planit Vendor për Rininë nga ekspertja e UNDP

Më pas, fjalën e mori znj. Lorena Zajmi, eksperte e angazhuar nga UNDP për hartimin e Planit Vendor Rinor 2026–2030 për Bashkinë Kamëz.

Ajo shpjegoi se plani përfshin 4 politika kryesore dhe 12 objektiva specifike:

Politika1. Fuqizimi i organizimit rinor dhe rritja e pjesëmarrjes rinore në jetën publike dhe vendimmarrje.

Fuqizimi i të rinjve për të kontribuar aktivisht në vendimmarrje dhe proceset komunitare.

- **Objektivi 1.1**-Forcimi i Këshillit Vendor Rinor dhe rritja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve .
- **Objektivi 1.2** – Forcimi i nismave rinore dhe hapësirave për zhvillimin e rinisë.
- **Objektivi 1.3** –Promovimi i kulturës, së vullnetarizmit dhe qytetarisë aktive tek të rinjtë.

Politika 2. Aftësimi, Punësimi dhe Inovacioni Rinor

Zhvillimi i aftësive të të rinjve dhe krijimi i mundësive konkrete për punësim dhe sipërmarrje.

- **Objektivi 2.1-** Aftësimidhe fuqizimi i të rinjve për punësim dhe zhvillim profesional.
- **Objektivi 2.2-** Mbështetje për tranzicionin nga arsimi drejt punësimit.
- **Objektivi 2.3-** Nxitja e sipërmarrjes së të rinjve dhe inovacionit.

Politika 3. Mbrotjtja dhe Shëndeti Mendor e Fizik i të Rinjve

Krijimi i një mjedisi mbështetës dhe të sigurt për shëndetin mendor dhe mirëqenien e të rinjve.

- **Objektivi 3.1-** Rritja e mbështetjes psikosociale dhe parandalimi i sjelljeve të rrezikshme të rinjtë.
- **Objektivi 3.2** -Nxitja e aktivitetit fizik, sportiv dhe rekreativ për të rinjtë.
- **Objektivi 3.3** - Rritja e përfshirjes sociale dhe mbështetjes për të rinjtë vulnerabël.

Politika 4. Kultura, Tradita dhe Angazhimi Komunitar i të Rinjve.

Promovimi i kulturës, traditës dhe angazhimit komunitar si mjete për zhvillim personal dhe social të të rinjve.

- **Objektivi 4.1** - Zhvillimi i kulturës, artit dhe sportit si mjete për përfshirje sociale dhe pjesëmarrje rinore.
- **Objektivi 4.2** - Krijimi dhe funksionalizimi i hapësirave rinore komunitare në çdo njësi.
- **Objektivi 4.3** - Promovimi i identitetit lokal dhe qytetarisë aktive për të rinjtë.

Për secilën politikë, me objektivat përkatëse, janë parashikuar aktivitete konkrete si trajnime, programe vullnetarizmi, kurse profesionale, aktivitete sportive dhe kulturore, si dhe iniciativa për përfshirjen sociale të të rinjve etj. Përmes këtyre aktiviteteve synohet rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën komunitare, zhvillimi i aftësive të tyre dhe krijimi i mundësive më të mira për integrimin e tyre në shoqëri dhe tregun e punës.

Pas prezantimit të planit, pjesëmarrësit u ftuan të ndanin mendimet dhe rekomandimet e tyre.

Diskutime dhe rekomandime

- **Përfaqësues i International Organization for Migration Tirana (IOM)** - Plani është gjithëpërfshirës dhe përfshinte aktivitete të rëndësishme. Një sugjerim, do të ishte e dobishme të krijohet një mekanizëm bashkëpunimi dhe shkëmbimi idesh ndërmjet të rinjve të diasporës dhe atyre të Kamzës.
- **I.C Antare e KVR-ës** - Do të ishte e dobishme që studentët dhe gjimnazistët e Kamzës të përfshihen në procesin e vendimmarrjes, duke marrë pjesë në Këshillin Bashkiak dhe duke propozuar ide dhe iniciativa për zhvillimin e qytetit të tyre.
- **L.B Antare e KVR-së** - Rritja e aktiviteteve që përfshijnë të rinjtë me aftësi të kufizuara në programme rinore.
- **G.D Minister Rinorë PNSH**- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Këshillit Vendor Rinor dhe strukturave të tjera rinore në nivel kombëtar.

- **A.R Perfaqësues nga YVNO-** Sa i përket Këshillit Vendor Rinor (KVR), me ligjin e ri ata angazhohen më shumë dhe marrin më shumë mbështetje, por kjo duhet të reflektohet edhe në planin lokal. Mendoj që duhet të rritet numeri i antarëve të KVR-ës.

Ekspertja e UNDP znj. Lorena Zajmi dhe përfaqësuesit e Bashkisë Kamëz theksuan se të gjitha sugjerimet do të shqyrtohen për tu përfshirë në versionin final të Planit Vendor Rinor.

Takimi u mbyll në orën 12:40.

Bashkëngjitur fotot:



